



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:155363

Datë: 24.03.2025

Numri i dokumentit: 07032063

CAP.nr.2114/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarin Ardian Ajvazi, në çështjen juridike të kreditorit, KUR “Mitrovica” Sh.A, kundër debitorit K.Ç. me adresë, lidhur me pagesën e borxhit në shumën prej 291.88 €, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.167/2023, të datës 15.11.2024, me datë 24.03.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e kreditorit KUR “Mitrovica” Sh.A, **PRISHET** Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë PPP.nr.167/2023, i datës 15.11.2024, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë, departamenti i përgjithshëm me aktvendimin e atakuar ka në pikën I., të dispozitivit ka aprovuar prapësimin e debitorit K. Ç. me adresë, ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimin P.nr.457/2023 të datës 30.05.2023, dhe në pikën II., të dispozitivit ka shfuqizuar urdhrin mbi lejimin e përmbarimin P.nr.457/2023 të datës 30.05.2023, dhe të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore abrogohen.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor ankesë ka parashtruar kreditori, për shkak të kontatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë si të bazuar ankesën ashtu që të anulohet aktvendimi PPPP.nr.167/23, ndërsa urdhri përmbrimor P.nr.457/23 i datës 30.05.2023 të lihet në fuqi.

Debitori, nuk ka ushtruar përgjegje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 dhe 194 të

Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se

Ankesa e kreditorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, KUR “Mitrovica” Sh.A, me datë 24.05.2023, ka ushtruar propozim për lejimin e përmbartimit kundër debitorit K. C., ndërsa Përmbartuesi Privat Saranda Rexhepi, me seli të zyrës në Komunën e Prishtinës, me urdhrin P.nr.457/2023 të datës 30.05.2023, ka lejuar përmbartimin e shumën 291.88 €, ndaj debitorit Xhemajl Çazimi.

Kundër Urdhrit për Përmbartim P.nr.457/2023 të datës 30.05.2023, debitori ka ushtruar prapësim brenda afatit të rregullt ligjor (datë 19.06.2023), fillimisht e ka njoftuar gjykatën se Xhemajl Çazimi ka vdekur dhe i njëjti posedon me pasurin e të ndjerit, po ashtu ka deklaruar se borxhi me të cilën ngarkohet është i parashkuara po ashtu ka deklaruar se është përfitues i asistencës sociale dhe ka bashkangjitur edhe kartelën sociale.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me të cilin ka kërkuar që të refuzohet prapësimi si i bazuar.

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin PPP.nr.167/2023 tani të atakuar, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit duke e shfuqizuar urdhrin përmbartimori P.nr.457/2023 të datës 30.05.2023.

Në arsyetim të Aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se fillimisht, gjykata konstaton faktin se meqenëse ushtruesi i prapësimit ka ofruar prova që e dëshmojnë faktin e vdekjes se Xhemajl Çazimi dhe se e merr përsipër procedurën përmbartimore dhe meqenëse kreditori nuk e ka kundërshtuar dhe ka kërkuar që të vazhdohet procedura me ushtruesin e prapësimit pasi që e ka marr përsipër procedurën përmbartimore, gjykata për shkak të ekonomizimit të procedurës konform nenit 35 të LPP-së, tani në cilësi të debitorit e caktoj K. Ç. si ushtrues i prapësimit. Gjykata gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për faktin se në bazë të nenit 14 i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbartimore parashihet që nenit 85 paragrafi 1 i shtohet edhe nën paragrafi 1.8 ku parashihet që *“përfshihen nga përmbartimi: të ardhurat në bazë të ndihmës sociale”*, ndërsa nga kartela për ndihmë sociale me numër 47242 të datës 04.04.2020, del se debitori hyn në kategorinë e personave që merr ndihmë sociale kurse dispozita ligjore e lartëcekur ka paraparë që të ardhurat në bazë të ndihmës sociale janë të përfshijtura nga përmbartimi.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjyqtari i Gjykatës së Apelit nuk e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n), nenit 182.1 lidhur me nenin 160 të LPK-së, si dhe nenit 71 të LPP-së, e po ashtu gjendja faktike nuk është vërtetuar si duhet e si rezultat i kësaj ka ardhur edhe deri te zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.

Gjykata ankimore gjatë vlerësimit të pretendimeve ankimore, gjen se pretendimet e kreditorit janë të bazuara për faktin se aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje të dispozitave nga neni 182.2 pika n) e LPK-së, për faktin se dispozitivi i aktvendimit është në kundërshtim me arsyetimin, po ashtu Gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me vendosjen sikurse në dispozitiv të aktvendimit, si dhe po ashtu edhe ato arsye që janë dhënë janë të mangëta, të pa qarta me çka rezulton që aktgjykimi si i tillë të jetë i pa qëndrueshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Gjykata e Apelit po ashtu vlerëson se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë për faktin se Gjykata e shkallës së parë është mjaftuar vetëm me arsyetimin se debitori është përfitues i ndihmave sociale duke e vlerësuar si provë –kartelën e ndihmës sociale, nr.47242 mirëpo, Gjykata ka dështuar që të vërtetojë saktë se a është kjo rrethanë që ndikon në aprovimin e prapësimit.

Neni 71 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 përcakton se: *“1. Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: 1.5. përmbarimi është caktuar për sendet të cilat janë të përjashtuara nga përmbarimi i detyrueshëm dhe, si rezultat i këtij përjashtimi, mundësit për kryerjen e përmbarimit janë të kufizuara;”*.

Neni 112 paragrafi 1 përcakton se: *“1. Përmbarimi në të ardhurat personale, për shpërblimin në vend të pagës dhe për pensionin, mund të caktohet dhe zbatohet deri në gjysmën e lartësisë së tyre. Shuma që sekuestrohet do të kufizohet në pjesën që tejkalon shumën e ndihmës më të lartë sociale që paguhet brenda territorit ku debitori ka vendbanimin.”*, ndërsa neni 14 i Ligjit për plotësim ndryshimin e Ligjit për Procedurën Përmbarimore përcakton se: *“Neni 85 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.7. shtohet nën-paragrafi i ri 1.8. me tekstin si në vijim: 1.8. të ardhurat në bazë të ndihmës sociale.”*.

Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret janë zbatuar gabimisht dispozitat e të drejtës materiale sepse sipas vlerësimit të kësaj Gjykate tani për tani debitori nuk mund të lirohet nga përmbushja e detyrimit. Nuk ka vlerësuar se kreditori mund ta realizoj kërkesën e tij nga pasuria tjetër e debitorit (nga sendet e luajtshme dhe të paluajtshme, të hyrat e tjera që mund t’i realizoj debitori). Pasi që të filloj ekzekutimi –zbatimi i përmbarimit të ardhurat në bazë të ndihmës sociale mund të shërbejnë si arsye për përjashtimin nga përmbarimi, ndërsa mund të jetë e mundur që kreditori ta realizojë borxhin në ndonjë mënyrë tjetër përveç nga të ardhurat në bazë të ndihmës sociale.

Procedura përmbarimore bazohet në parimin e rigorizitetit formal, për çka gjykata në këtë procedurë nuk ka të drejtë që të shqyrtoj dhe vlerësoj aspektet e përmbajtjes së titullit përmbarimor, por vetëm çështjen e plotësisimit të kushteve formale të parapara me LPP, që kanë të bëjnë me ligjshmërinë e titullit përmbarimor (neni 22, 27 dhe 29 të LPP).

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura, ashtu që të vlerësojë çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe të ketë parasysh pretendimet e palëve në procedurë, e në veçanti të eliminoj shkeljet e konstatuara nga

kjo Gjykatë, e më pas të marr të marr vendim meritor, të drejtë dhe të ligjshëm duke i zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së., u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.2114/2024, me datë 24.03.2025

Gjyqtari
Ardian Ajvazi